- d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;
- e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.
4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës [Ekonomike](#)

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Formulari i Termave të Referencës

Shtojca 9: Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit.

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimit.

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE³

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi -të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontratës;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

³ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;

7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**
_____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës Ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

1	2	3	4	5	
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total				_____
Çmimi Neto pa TVSH					

TVSH (%)	
Çmimi total me TVSH:	
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Date _____	

Shtojca 3.

[*Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik*]

[*Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve*]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [*Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor*]

Në emër të: [*Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar*]

* * *

Procedura e prokurimit [*lloji i procedurës*]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [*objekti*]

Publikimi (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike [*Data*] [*Numri*] / Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [*emri i autoritetit/entit kontraktor*] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [*njoftimin e kontratës*].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit**Nënshkrimi****Vula**

Shtojca 5.

(⁴Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË**Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit**

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik “.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objektështë i pamiratuar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

⁴ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Shtojca 6.

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor*]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Specifikime Teknike “Shërbimi i mirëmbajtjes së gjelbërimit”

Zhvillimi teknologjiko-industrial global sjell ndotje të ambientit dhe politikat globale në përgjithësi orientohen drejt mirëmbajtjes dhe shtimit të hapësirave të gjelbërta. Në këtë kuptim sigurisht që edhe Bashkia Kavajë nuk mund të mos ketë objekt kryesor përmirësimin dhe zgjerimin e sipërfaqeve të gjelbërta.

Në rang kombëtar pavarësisht se Kavaja nuk bën pjesë ndër qytetet me ndotjen më të lartë të ajrit kemi detyrimin, që ne zbatim të ligjit nr.10431 datë 09.06.2011 i ndryshuar “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, të marrim masat për parandalimin e këtij fenomeni dhe përmirësimin e gjëndjes.

Gjelbërimi i qytetit gjithashtu është edhe çështje vizuale. Lumturia e banorëve ndikohet patjetër nga ambienti ku jetojnë dhe punojnë. Nëse kemi një ambient të përshtatshëm dhe komod sigurisht edhe banorët do të jenë më të lumtur. Përveç faktit se lumturia sjell edhe produktivitet më të madh në fund të fundit lumturia është qëllimi parësor në jetë.

Bashkia Kavajë ka si prioritet që brenda këtij 5-vjecari të mundësojë rehabilitimin dhe më pas mirëmbajtjen e sipërfaqeve të gjelbërta në kushtet më optimale të mundshme.

Autoriteti Kontraktor ka parashikuar paraprakisht sipërfaqet e gjelbërta, numrin e drurëve dekorativ, bordurave të gjelbërta, si dhe hapësirat për rinovimin e sipërfaqeve të gjelbërta dhe mbjelljes së luleve sezonale.

A. Mirëmbajtja e sipërfaqeve të gjelbërta, drurëve dekorative dhe bordurës së gjelbër

Volumet e punimeve objekt i shërbimit të mirëmbajtjes janë sipas të dhënave të mëposhtme:

- 51,534 m2 sipërfaqe të gjelbërt
- 11,361 copë dru dekorativ (nga të cilët 338 copë palma)
- 5,161 ml bordure e gjelbër (shkurre dekorative)
- 153,116 m2 trotuare dhe sheshe
- 200 copë stola
- 43,000 m2 sipërfaqe me bar në territorin e varrezave të qytetit

Volumet e mësipërme përfshijnë të dhëna në të gjithë territorin e Bashkisë Kavajë, në të cilën përfshihen gjithashtu edhe Njësitë Administrative Synej, Luz I Vogël, Helmas dhe Golem.

I. Mirëmbajtja e sipërfaqeve të gjelbërta

1. Pastrim me krehër i barit. Krehja e sipërfaqeve të gjelbërta me krehër metalik do të kryhet me një frekuencë 12 herë në vit. Shërbimi do të realizohet kryesisht në sipërfaqet e barit duke ruajtur një pamje estetike të tij. Për largimin e mbetjeve do të përdoren karroca dore.
2. Pastrim i sipërfaqeve të barit me punëtorë me fshesa nga papastërtitë. Shërbimi i pastrimit me punëtorë me fshesa të përshtatshme do të kryhet në të gjithë sipërfaqen e lulishteve duke larguar çdo mbetje dhe papastërti me një frekuencë 2 herë në muaj ose 24 herë në vit. Për transportimin e mbetjeve deri në kontenier do të përdoren karroca dore. Ndalohen vendet e grumbullimit të mbetjeve për evadime të mëvonshme në territoret urbane të vendit.
3. Kositje bari me makinë korrëse (90% e sip). Kostitja është një shërbim që fillon në Prill dhe përfundon në Tetor, i cili do të duhet të kryhet me një frekuencë 12 herë në vit me makina korrëse duke respektuar të gjitha rregullat agroteknike. Aty ku është e pa mundur përdorimi i makinave korrëse do të përdoren kosa motorrike.
4. Kositje bari me kosë motorrike (10% e sip). Aty ku është e pa mundur përdorimi i makinave korrëse do të përdoren kosa motorrike. Kostitja është një shërbim që fillon në Prill dhe përfundon në Tetor, i cili do të duhet të kryhet me një frekuencë 12 herë në vit duke respektuar të gjitha rregullat agroteknike.
5. Vadtje tapet bari. Vadtja do të realizohet me një frekuencë 12 herë në vit dhe kryesisht do të jetë e përqëndruar në shërbime gjatë periudhës Prill - Shtator, por në raste të veçanta edhe në stinë të tjera. Operatori i Shërbimit duhet të kryejë shërbimin e vaditjes duke respektuar standartin e harxhimit të 10 litër ujë për 1 m2. Lagia duhet të bëhet me ujë me ngarkesë bakteriale jo më shumë se 200 E koli për 100ml ujë. Vadtja do të kryhet kryesisht gjatë orëve të mëngjesit dhe

gjatë natës me anë të autoboteve të pajisur me tub për nxjerrjen e ujit me presion në pjesën anësore të tij, me kapacitet mbajtës jo më pak se 10,000 litra ujë. Operatori i Shërbimit duhet të sigurohet që të mos ketë ndërprerje të ujit të rrjedhshëm si dhe mirëmbajtjes së mjetit për të mos ndërprerë vijueshmërinë e punës. Të gjitha shpenzimet për ujin, që do të përdoret për vaditje do mbarten nga operatori i shërbimit.

6. Plehërim i tapetit të barit. Produktet plehruese duhet të jenë me shkrirje të ngadaltë me përmbajtje azoti, fosfori dhe kaliumi për të përmbushur sa më mirë nevojat agroteknike të tapetit të barit dhe do të bëhet 4 herë në vit në të gjithë sipërfaqen. Operatori i Shërbimit duhet të kryejë plehërimin e tapetit të barit me pleh kimik duke respektuar standartin 0,04 kg pleh kimik për 1 m². Produktet plehruese duhet të jenë të regjistruara dhe të lejuara sipas legjislacionit në fuqi, do të ndalohej përdorimi i produkteve plehruese të paregjistruara; produkteve plehruese me përmbajtje substancash të dëmshme, të cilat mund të përbëjnë rrezik për sigurinë ose shëndetin e njerëzve, kafshëve ose bimëve, ose një rrezik për mjedisin.
7. Kositje bari me kosë motorrike në sipërfaqen e varrezave. Siperfaqja totale e varrezave është 348,350 m², nga të cilat sipërfaqe me bar janë 104,505 m². Kositja do të kryhet me kosa motorrike 12 herë në vit duke respektuar të gjitha rregullat agroteknike.

II. Mirëmbajtje e drurëve dekorativ

1. Punim me bel, 20 - 25cm thellësi. Punim me bel I tokës përreth pemës është një proces i domosdoshëm jo vetëm si nevojë biologjike por shërben edhe për rritjen e dekorit. Punim me bel do të kryhet 1 herë gjatë një viti kontraktual. Punim me bel, 20 - 25cm thellësi ndikon në
 - Pengimi e avullimit të ujit nga toka, sepse thyhen kapilaret e sipërfaqes së tokës;
 - Luftimin e barerave të keqja;
 - Siguron një regjim aero-dinamik të shtresës së punueshme të tokës, të sistemit rrenjor, etj.
 Punim me bel do të kryhet me vegla pune manuale dhe evakuimi i papastërtive do të bëhet me karrocë dore. Koha më e favorshme për realizimin e punimit me bel është periudha e fundvjeshtës dhe dimrit.
2. Prashitje (frezim, shkriftim) 10 - 12cm thellësi dhe plehërim. Dy herë në vit, e para në muajt Prill – Maj dhe e dyta në Shtator. Operatori i Shërbimit duhet të kryejë fillimisht prashitjen dhe më pas plehërimin me pleh kimik duke respektuar standartin 0,04 kg pleh kimik për çdo rrënjë të drurëve dekorativ.

3. Krasitje drurësh deri 20 vjet. Krasitja e drurëve dekorative do të kryhet duke larguar të gjitha degët e thata dhe krasitjen e degëve me qëllim rritjen e tyre. Drurët do të krasiten duke filluar nga muaji Dhjetor e në vazhdim. Drurët gjetherënës përfundojnë krasitjen në fillim të muajit Mars, kurse ato gjethembajtës krasiten në çdo kohë, me një frekuencë 1 herë në vit. Krasitja do të realizohet me ndihmën e vincit me kosh dhe transporti I degëve apo mbeturinave të tjera do të behet me kamionçinë 3-5 ton deri në 5 km.
4. Krasitje palmash. Krasitja do të kryhet duke larguar të gjitha degët e thata dhe pastrimin e trungut të palmës deri në lartësinë ku fillojnë degët. Krasitja do të bëhet me një frekuencë 1 herë në vit. Krasitja do të realizohet me ndihmën e vincit me kosh dhe transporti I degëve apo mbeturinave të tjera do të behet me kamioncine 3-5ton deri në 5 km.
5. Punim rreth kurorës dhe dhënie formë. Dhënia formë e drurëve dekorative do të kryhet 2 herë në vit. Forma e kurorave të tyre të jetë në formën gjeometrike të kërkuar dhe vizualisht e bukur. Krasitja do të realizohet me ndihmën e shkallëve apo vincit me kosh dhe evadimi i mbeturinave do të bëhet me karrocë dore.
6. Vaditje dru dekorativ. Vaditja do të realizohet me frekuencë 6 herë në vit dhe kryesisht do të jetë e përqëndruar në shërbime gjatë periudhës Prill - Shtator, por në raste të veçanta edhe në stinë të tjera. Operatori i Shërbimit duhet të kryejë shërbimin e vaditjes duke respektuar standartin e harxhimit 50 litër ujë për dru dekorativ. Lagia duhet të bëhet me ujë me ngarkesë bakteriale jo më shumë se 200 E koli për 100ml ujë. Vaditja do të kryhet kryesisht gjatë orëve të mëngjesit dhe gjatë natës me anë të autobotëve të pajisur me tub për nxjerrjen e ujit me presion në pjesën anësore të tij, me kapacitet mbajtës jo më pak se 10,000 litra ujë. Operatori i Shërbimit duhet të sigurohet që të mos ketë ndërprerje të ujit të rrjedhshëm si dhe mirëmbajtjes së mjetit për të mos ndërprerë vijueshmërinë e punës. Të gjitha shpenzimet për ujin, që do të përdoret për vaditje do mbarten nga operatori i shërbimit.
7. Spërkatje me insekticide dru dekorativ. Spërkatja me insekticid për mbrojtjen e bimëve është parashikuar të kryhet 2 herë në vit dhe mjetet që do të përdoren për këtë proces do të jenë pompat me spërkatje. Operatori i Shërbimit duhet të kryejë spërkatjen me pesticide duke respektuar standartin 0,005 kg pesticid për 1 copë.

III. Mirëmbajtje bordurë e gjelbër

1. Punim me bel, 20 - 25cm thellësi i bordurës së gjelbër. Punim me bel është një proces I domosdoshëm për:
 - Pengimin e avullimit te ujit nga toka, sepse thyhen kapilaret e siperfaqes se tokes;
 - Luftimin e barerave te keqia;
 - Siguron nje regjim aero-dinamik te shtreses se punueshme te tokes, te sistemit rrenjor, etj.

Punim me bel do të kryhet me një frekuencë 1 herë në vit. Gjatë punim me bel do të kryhet në mënyrë të vazhdueshme pastrimi i barit të keq i cili dëmton ato dhe influencon negativisht ndaj dekorit të kërkuar. Punim me bel do të kryhet me vegla pune manuale dhe evakuimi I papastërtive do të bëhet me karrocë dore.
2. Prashitje (frezim, shkruftim) 10 - 12cm thellësi dhe plehërim. Tre herë në vit, Operatori i Shërbimit duhet të kryejë fillimisht prashitjen (frezim, shkruftim) dhe më pas plehërimin me pleh kimik duke respektuar standartin 0,04 kg pleh kimik për 1ml.

3. Krasitje bordurë e gjelbër dhe dhënie formë. Krasitja dhe dhënia formë e shkurreve do të kryhet 6 herë në vit në periudhën Prill deri në Tetor duke përdorur mjete mekanike dhe manuale, me qëllim ruajtjen e formës së përcaktuar. Krasitja do të kryhet duke i dhënë formën gjeometrike të kërkuar dhe vizualisht e bukur. Evadimi I mbeturinave do të bëhet me do të bëhet me karrocë dore.
4. Vadtje bordurë e gjelbër. Vadtja do të realizohet me frekuencë 12 herë në vit dhe kryesisht do të jetë e përqëndruar në shërbime gjatë periudhës Prill - Shtator, por në raste të veçanta edhe në stinë të tjera. Operatori i Shërbimit duhet të kryejë shërbimin e vadtjes duke respektuar standartin e harxhimit 50 litër ujë për metër linear bordurë e gjelbër. Lagia duhet të bëhet me ujë me ngarkesë bakteriale jo më shumë se 200 E koli për 100ml ujë. Vadtja do të kryhet kryesisht gjatë orëve të mëngjesit dhe gjatë natës me anë të autoboteve të pajisur me tub për nxjerrjen e ujit me presion në pjesën anësore të tij, me kapacitet mbajtës jo më pak se 10,000 litra ujë. Operatori i Shërbimit duhet të sigurohet që të mos ketë ndërprerje të ujit të rrjedhshëm si dhe mirëmbajtjes së mjetit për të mos ndërprerë vijueshmërinë e punës. Të gjitha shpenzimet për ujin, që do të përdoret për vadtje do mbarten nga operatori i shërbimit.
5. Spërkatje me insekticide bordurë e gjelbër. Spërkatja me insekticid për mbrojtjen e sipërfaqeve të bordurave të gjelbërta është parashikuar të kryhet 2 herë në vit dhe mjetet që do të përdoren për këtë proces do të jenë pompat me spërkatje. Operatori i Shërbimit duhet të kryejë spërkatjen me pesticide duke respektuar standartin 0,005 kg pesticid për 1 metër katror bordurë e gjelbër.

IV. Rinovim i sipërfaqeve të gjelbërta

Volumi i punimeve

Operatori i Shërbimit duhet të kryejë rinovimin e një sipërfaqeje prej 5,153 m² në vit (10% e sipërfaqes totale), sipas kërkesës dhe përcaktimit të Autoritetit Kontraktor.

Shërbimi i rinovimit të hapësirave të gjelbërta publike konsiston në:

1. Punimi i parë i tokës në një thellësi 25-30 cm.
2. Shkriftim dhe thyerje plisash duke bërë pastrimin e gurëve, rrënjëve dhe çdo papastërtie tjetër.
3. Sheshim i dheut pas punimit të tokës.
4. Shpërndarje plehu organik. Operatori i Shërbimit duhet të kryejë shpërndarjen e plehut organik duke respektuar standartin 2 kg pleh organik për 1 m².
5. Punim i dytë i tokës në 15- 20 cm thellësi duke mbuluar plehun.
6. Krehje, nivelim dhe mbledhje mbeturinash duke larguar çdo mbetje dhe papastërti. Për transportimin e mbetjeve deri në kontenier do të përdoren karroca dore.
7. Mbjellje e farës së barit. Operatori i Shërbimit duhet të kryejë mbjelljen e barit duke respektuar standartin 0,05 kg farë bari për 1 metër katror sipërfaqe .
8. Rrulim dhe ngjeshje pas mbjelljes .
9. Vadtje e sipërfaqes së barit. Vadtja do të realizohet me një frekuencë 3 herë, duke respektuar standartin e harxhimit të 10 litër ujë për 1 m². Vadtja do të kryhet me anë të autoboteve të pajisur me tub për nxjerrjen e ujit me presion në pjesën anësore të tij, me kapacitet mbajtës jo më pak se 10,000 litra ujë. Operatori i Shërbimit duhet të sigurohet që të mos ketë ndërprerje të ujit të

rrjedhshëm si dhe mirëmbajtjes së mjetit për të mos ndërprerë vijueshmërinë e punës. Të gjitha shpenzimet për ujin, që do të përdoret për vaditje do mbarten nga operatori i shërbimit.

V. Rinovim bordurë e gjelbër (10 %)

1. Germim dheu me ekskavator, ne kanale gjerësi 15x20cm, toke zakonshme, me shkarkim ne toke. Hapja e kanalit për mbjelljen me shkurre do te bëhet në të njëjtën vijë lineare të bordurës së gjelbër që rinovohet.
2. Shperndarje plehu organik . Operatori i Shërbimit duhet të kryejë shpërndarjen e plehut organik duke respektuar standartin 2 kg pleh organik për 1 m2.
3. F.V. shkurre dekorative Leandra. Operatori i Shërbimit duhet të kryejë mbjelljen e 2000 copë shkurre dekorative Leandra e lulëzuar me lartësi ≥ 80 cm gjate nje viti kontraktor. Mbjellja do të bëhet 5 bime për ml bordurë e gjelbër.
4. F.V. shkurre dekorative Trendafil. Operatori i Shërbimit duhet të kryejë mbjelljen e 500 copë shkurre dekorative Trëndafil i lulëzuar me lartësi ≥ 80 cm gjate nje viti kontraktor. Mbjellja do të bëhet 5 bime për ml bordurë e gjelbër.
5. Vaditje. Vaditja do të realizohet me një frekuencë 3 herë, me anë të autoboteve të pajisur me tub për nxjerrjen e ujit me presion në pjesën anësore të tij, me kapacitet mbajtes jo më pak se 10,000 litra ujë. Operatori i Shërbimit duhet të sigurohet që të mos ketë ndërprerje të ujit të rrjedhshëm si dhe mirëmbajtjes së mjetit për të mos ndërprerë vijueshmërinë e punës. Të gjitha shpenzimet për ujin, që do të përdoret për vaditje do mbarten nga operatori i shërbimit.

VI. Mbjellje e sipërfaqeve me lule sezonale.

1. F.V. Lule dekorative sezonale e celur. Tre herë në vit, Operatori i Shërbimit duhet të kryejë mbjelljen e një sasive prej 3000 copë lule sezonalee celur në vit. Plehërimi me pleh kimik bëhet duke respektuar standartin 0,04 kg pleh kimik për 1m2 ose 0.01 kg me pleh kimik për copë.
2. Vaditje lule sezonale e celur. Do të realizohet me një frekuencë 6 herë në vit ose një herë në dy javë me anë të autoboteve të pajisur me tub për nxjerrjen e ujit me presion në pjesën anësore të tij, me kapacitet mbajtes jo më pak se 10,000 litra ujë. Operatori i Shërbimit duhet të sigurohet që të mos ketë ndërprerje të ujit të rrjedhshëm si dhe mirëmbajtjes së mjetit për të mos ndërprerë vijueshmërinë e punës.
3. Shkulje rrënjësh dhe nxjerrje jashtë parcele pas tharjes. Ky shërbim do të kryhet pas përfundimit të jetëgjatësisë se luleve sezonale duke larguar çdo mbetje dhe papastërti të mbetur pas tharjes së tyre. Transportimi I mbetjeve do të kryhet me karroca dore. Ndalohen vendet e grumbullimit të mbetjeve për evadime të mëvonshme në territoret urbane të vendit.

VII. Mirëmbajtje e trotuare dhe sheshe.

1. Skarifikim bari me lopate ose pastrami i fugave të trotuareve. Do të realizohet në një frakuencë 6 herë në vit në sipërfaqet e nevojshme duke larguar çdo mbetje dhe papastërti.

2. Transport mbeturinash me karroce dore. Pas procesit të pastrimit të fugave, për transportin e mbetjeve deri në kontenier do të përdoren karroca dore.
3. Riparim stolash të dëmtuar. Një herë në vit, Operatori i Shërbimit duhet të kryejë shërbimin e mirëmbajtjes dhe riparimit të 100 stolave. Ky shërbim konsiston në zëvendësimin e binarëve të dëmtuar apo atyre që mungojnë me të rinj, lyerjen me bojë e llak kundra lagështirës dhe montimin e tyre. riparimin/rinovimin e binarëve përbërës së stolave.
4. Pastrim dhe lyerje stolash. Një herë në vit, Operatori i Shërbimit duhet të kryejë shërbimin e mirëmbajtjes së stolave në territorin e Bashkisë Kavajë. Ky shërbim konsiston në zmerilimin e bojës së meparshme, pastimin e tyre dhe lyerjen me bojë e llak kundra lagështirës.

B. Rregulla për tu zbatuar

Autoriteti kontraktor ka të drejtë të kontrollojë në çdo kohë si gjatë kryerjes së shërbimit dhe pas përfundimit të tij.

Grafikët e punimeve për realizimin e shërbimit, përgatiten nga Kontraktuesi dhe miratohen çdo vit nga Autoriteti Kontraktor.

Në grafikun e punimeve duhet të përcaktohen saktë: ditët e operimit dhe procesi që do të kryhet.

Për grumbullimin dhe ngarkimin e mbetjeve, në ato sipërfaqe ku volumet e mbetjeve janë të mëdha do të përdoren kamionçina vetshkarkuese me mbulesa të posaçme për mos lejuar derdhjen e mbetjeve kurse për volume më të vogla me mjete të thjeshta dore si karrocet e dorës.

Kontraktuesi duhet të kryejë grumbullimin dhe transportimin e të gjitha mbetjeve që rezultojnë nga pastrimi, kositja dhe krasitja në vende të miratuara për depozitim.

Paga bazë për ditë pune është përcaktuar paga minimale sipas vendimit nr.809, datë 26.12.2018 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi “

Kontraktuesi realizon një plan organizimi për shpërndarjen e punëtorëve për të kryer shërbimet përkatëse. Kontraktuesi do të realizojë dhe planin e lejeve të zakonshme që i takon me ligj cdo punëtori dhe ky plan nuk duhet të çenojë aspak nevojën e shërbimit të sipërfaqeve të gjelbërta.

Gjatë orarit të punës apo gjatë kryerjes së shërbimeve rutinë, të gjithë punëtorët do të jenë të paisur me me mjetet përkatëse të punës dhe duhet të jenë të veshur me uniformën përkatëse të dallueshme.

Kontraktuesi duhet të ketë në dispozicion një sipërfaqe prej 1000m² që do të shërbejë për parkimin e mjeteve, për depozitimin e pajisjeve dhe veglave të punës apo depozitimin e materialeve bazë në funksion të shërbimit të gjelbërimit.

Kontraktuesi ndalohej të parkoj automjetet e shërbimit në ndonjë vend tjetër jashtë orarit të shërbimit.

Automjetet objekt I kontratës gjatë realizimit të shërbimit duhet të jenë të pastra, estetikisht të rregullta dhe të pajisura me dokumentacionin përkatës.

Automjetet objekt I kontratës duhet të jenë të loguara me shenjat dalluese të Kontraktuesit.

Pagesat e punimeve të kryera. Situacionet

Pagesat e punimeve (situacionet) të realizuara kryhen nëpërmjet volumit të punimeve të reflektuara në proces-verbalet të pjesshme, ditore, javore, mujore, të mbajtura ndërmjet përfaqësuesit të subjektit

(sipërmarrësit) dhe mbikqyresit (supervizorit) të Bashkisë duke llogaritur me çmimet e preventivave të fituar me tender për çdo zë punimi sezonal, të cilat janë të specifikuara në preventivat përkatës. Pagesat ndryshojne nga muaji në muaj sipas shërbimeve që do të kryhen në periudhat e përcaktuara në preventive.

Të gjitha punimet e realizuara shprehen në situacione mujore (financiare) të firmosura nga subjekti sipërmarrës dhe mbikqyresi(supervizori i Bashkisë).

Në raste kur krijohen dhe evidentohen dëmtime në sipërfaqe të gjelbërta për arsye të moskryerjes së shërbimeve në kohën e duhur, mbikqyrësi i punimeve në bazë të proces-verbaleve të mbajtura llogarit vlerën e dëmit të krijuar dhe bën zbritjen në situacionin përkatës.

Për çdo ndryshim të volumit të punimeve apo të rritjes ose zvogëlimit të inventareve dhe për çdo ndryshim të pagës minimale nga shteti,bëhen edhe ndryshimet në preventivë,rrjedhimisht në llogaritjen e fondeve vjetore dhe pagesat në situacione.

Vendi dhe dorëzimi i shërbimeve

Shërbimet do të kryhen në të gjithë territorin e Bashkisë Kavajë, në të cilin përfshihen gjithashtu edhe Njësitë Administrative Synej, Luz I Vogël, Helmas dhe Golem, sipas sipërfaqeve dhe të dhënave të përcaktuar në inventarin dhe preventivin për këtë objekt.

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet:

PREVENTIV "SHËRBIMI I MIRËMBAJTJES SË GJELBËRIMIT "

Nr.	EMËRTIMI I SHËRBIMEVE	Njësia	Frekuenca (here/vit)	Sasia	Sasia / vit	Çmimi / njësi	Vlera
		1	2	3	4=2*3	5	6= 4 x 5
I	MIRËMBAJTJE E SIPËRFAQEVE TE GJELBËRTA						
1	Pastrim me krehër i barit	m2	12	51,534	618,408		-
2	Pastrim I sipërfaqeve të barit me punëtorë me fshesa	m2	24	51,534	1,236,816		-
3	Kositje bari me makinë korrëse (90% e sip)	m2	12	46,381	556,567		-
4	Kositje bari me kosë motorrike (10% e sip)	m2	12	5,153	61,841		-
5	Vaditje tapet bari	m2	12	51,534	618,408		-
6	Plehërim i tapetit të barit me pleh kimik	m2	4	51,534	206,136		-
7	Kositje bari me kosë motorrike në sipërfaqet e varrezave	m2	12	43,000	516,000		-
SHUMA 1							-
II	MIRËMBAJTJE E DRURËVE DEKORATIV						
1	Punim me bel, 20 - 25cm thellësi	m2	1	4,544	4,544		-
2	Prashitje (frezim, shkruftim) 10 - 12cm thellësi dhe plehërim	m2	2	4,544	9,088		-
3	Krasitje drurësh deri 20 vjet	copë	1	11,023	11,023		-
4	Krasitje palmash	copë	2	338	676		-
5	Punim rreth kurorës dhe dhënie formë	copë	2	11,023	22,046		-
6	Vaditje dru dekorativ	copë	6	11,361	68,166		-
7	Spërkatje me insekticide dru dekorativ	copë	2	11,361	22,722		-
SHUMA 2							-
III	MIRËMBAJTJE BORDURË E GJELBËR						

1	Punim me bel, 20 - 25cm thellësi	m2	1	2,709	2,709		-
2	Prashitje (frezim, shkriftim) 10 - 12cm thellësi dhe plehërim	m2	3	2,709	8,127		-
3	Krasitje bordurë e gjelbër dhe dhënie formë	ml	6	5,161	30,966		-
4	Vaditje bordurë e gjelbër	m2	12	3,612	43,344		-
5	Spërkatje me insekticide bordurë e gjelbër	ml	2	5,161	10,322		-
						SHUMA 3	-
IV	RINOVIM I SIPËRFAQEVE TË GJELBËRTA						
1	Punim I parë me bel (25-30 cm)	m2	1	5,153	5,153		-
2	Punim I dytë me bel (15- 20 cm)	m2	1	5,153	5,153		-
3	Shkriftim dhe thyerje plisash	m2	1	5,153	5,153		-
4	Sheshim dheu pas punimit (para nivelimit)	m2	1	5,153	5,153		-
5	Shpërndarje plehu organik	m2	1	5,153	5,153		-
6	Nivelim, mbledhje mbeturinash	m2	1	5,153	5,153		-
7	Mbjellje e farës së barit	m2	1	5,153	5,153		-
8	Rulim dhe ngjeshje pas mbjelljes	m2	1	5,153	5,153		-
9	Vaditje e sipërfaqes së barit tw rinovuar	m2	3	5,153	15,459		-
						SHUMA 4	-
V	RINOVIM BORDURË E GJELBËR (10 %)						
1	Germim dheu me ekskavator, ne kanale gjeresi 15x20cm, toke zakonshme, me shkarkim ne toke	m3	1	9	9		-
2	Shpërndarje plehu organik	m2	1	361	361		-
3	F.V. shkurre dekorative Leandra	copë	1	2,000	2,000		-
4	F.V. Shkurre dekorative Trendafil	copë	1	500	500		-
5	Vaditje bordurë e gjelbër e rinovuar	m2	3	361	1,083		-
						SHUMA V	-
VI	MBJELLJE E SIPËRFAQEVE ME LULE SEZONALE						
1	F.V. Lule dekorative sezonale e celur	copë	3	1,000	3,000		-
2	Vaditje lule dekorative sezonale e celur	m2	6	3,000	18,000		-
3	Shkulje rrenjesh dhe nxjerrje jashte parcele pas tharjes	m3	1	5,000	5,000		-
						SHUMA VI	-
VII	MIRËMBAJTJE TROTUARE, SHESHE DHE BUZE RRUGE						
1	Skarifikim bari me lopate	m2	6	23,405	140,430		-
2	Transport mbeturinash me karroce dore	m3	6	10	60		-

3	Riparim stolash të dëmtuar	copë	1	100	100		-
4	Pastrim dhe lyster stolash	m2	1	134	134		-
SHUMA VII							-
SHUMA 1-7							-
TVSH 20%							-
TOTALI I VITIT TE PARE							-
VLERA E VITIT TE DYTE PERFSHIRE NORMEN MESATARE TE INFLACIONIT 2%							-
VLERA E VITIT TE TRETE PERFSHIRE NORMEN MESATARE TE INFLACIONIT 2%							-
VLERA E VITIT TE KATERT PERFSHIRE NORMEN MESATARE TE INFLACIONIT 2%							-
VLERA E VITIT TE PESTE PERFSHIRE NORMEN MESATARE TE INFLACIONIT 2%							-
TOTALI I PESE VITEVE ME TVSH							-

Afatet e ekzekutimit: 60 muaj

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

Detyrat:

Shpërndarja:

Vendi i kryerjes së shërbimeve:

Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

➤ Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

➤ Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- 1.1.1.2.2.1. Kopje të deklaratave të xhiros vjetore të viteve 2022, 2023 dhe 2024, lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo më të vogël se vlera e fondit limit. Në zbatim të nenit 43, pika 3, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar mësipër. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit, në raport me përqindjen (elementet konkrete) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.
- 1.1.2. Kopje të çertifikuara të balanceve të viteve 2022, 2023 dhe 2024 të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika "c", të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar. Në zbatim të nenit 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.
- 1.1.3. Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2025, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Për të përmbushur kërkesën e mësipërme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Referuar VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" neni 26 pika 6, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor dokumentacionin provues i përcaktuar mësipër përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit. Referuar nenit 26 pika 7, kanë për detyrë të japin sqarime dhe dokumente mbështetëse mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar, në cdo rast, me kërkesë të Autoritetit Kontraktor.

1.2. Për kapacitetin teknik:

- 2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e hapjes së ofertave ekonomike, në një vlerë jo më të vogël se 25% të vlerës së përllogaritur të fondit limit. Për të provuar përvojën e mëparshme, duhet që:
1. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik si dëshmi për përvojën e mëparshme të paraqiten kontrata ose kontratat e shërbimit, vërtetimi/et e realizimit me sukses të lëshuar për të njëjtën kontratë dhe faturën/faturat tatimore të shitjes (situacionet), të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara..
 2. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rast se kontratat e ngjashme janë lidhur nga një bashkim operatorësh ekonomikë duhet të paraqiten edhe kontratat e bashkëpunimit midis tyre.

Në rast se kontrata/kontratat e ngjashme janë lidhur në cilësinë e nënkontraktorit, operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesin gjithashtu kontratën/kontratat bazë të lidhur me Autoritetin Kontraktor, në të cilën të jenë përfshirë dhe detyrimet e marra përsipër për t'u realizuar nga nënkontraktori.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2.3.2.Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të jenë të pajisur me licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, të kategorisë NP-12 (punime të inxhinierisë së mjedisit).

2.3.3.Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të kenë stafin e tyre teknik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit

1. Për të provuar këtë kapacitetet, operatorët ekonomikë ofertues duhet të përcaktojnë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të shërbimit shoqëruar me kontratë të vlefshme pune, librezë pune dhe CV, I cili duhet të jetë i listuar në Listëpagesat e operatorit ekonomik gjatë periudhës Dhjetor 2025-Shkurt 2026.
2. Për të provuar këtë kapacitetet, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor kontratë të vlefshme pune, diplomë, librezë pune, CV dhe certifikatë të lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial / ekuivalente për 1 (një) Inxhinier Agronom/Pyjesh/Agrar, 1 (një) Inxhinier Mjedisit dhe 1 (një) Arkitekt Peisazhi. Stafi i mësipërm, duhet të jetë i listuar në Listëpagesat e operatorit ekonomik gjatë periudhës Dhjetor 2025-Shkurt 2026.
3. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor kontratë të vlefshme pune dhe dëshmi të kualifikimit profesional/diploma/certifikata trajnimi nga një organizëm i akredituar/licencuar /certifikuar shqiptar ose i huaj për 1 (një) ekspert që përmbush kriteret për të qenë koordinator në fushën e sigurisë dhe të shëndetit gjatë realizimit të shërbimeve, sipas kërkesave të ligjit nr. 10237 date 18.02.2010 “Per sigurine dhe shendetin ne pune” dhe V.K.M. nr. 312, date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”.
4. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor kontratë të vlefshme pune dhe dëshmi të kualifikimit profesional/diploma/certifikata trajnimi nga një organizëm i akredituar/licencuar /certifikuar shqiptar ose i huaj për 1 (një) ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave, sipas kërkesave të ligjit nr. 10237 date 18.02.2010 “Per sigurine dhe shendetin ne pune” dhe V.K.M. nr. 312, date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”.
5. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor kontratë të vlefshme pune dhe certifikatë të lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial/ekuivalente dhe të vlefshme për 3(tre) specialist kosites siperfaqe e gjelbert, 2 (dy) luleshtar, 2 (dy) karpentier dhe 2 (dy) bojaxhinj. Stafi i mësipërm, duhet të jetë i listuar

në Listëpagesat e operatorit ekonomik të paktën gjatë periudhës Dhjetor 2025-Shkurt 2026.

6. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor kontratë të vlefshme pune dhe leje drejtimi përkatëse për 2 (dy) manovrator dhe 3(tre) shoferë të kategorisë përkatëse. Staf i mësipërm, duhet të jetë i listuar në Listëpagesat e operatorit ekonomik gjatë periudhës Dhjetor 2025-Shkurt 2026.

